



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova**  
**Ministry of Internal Affairs**

**Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-Departament za Upravljanje Javnim Službenicima-**  
**Department for Management of Public Officials**

Nr. **1326** 2023  
Datë: 28.08.2023

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në pajtim me nenin 4, 5, 51 (paragrafi 4), 53, 55 (paragrafi 1) dhe nenit 58 të Ligjit Nr.05/L – 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për anulim diskrecionar të aktit me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë/anulim i konkursit me numër të referencës RN00012066**

1. Anulohet konkursi publik me numër të referencës RN00012066, për pozitën: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Ministria e Shëndetësisë për shkak të lëshimeve materiale në draftin e konkursit.
2. Rishpallet konkursi për pozitën: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Ministria e Shëndetësisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pas përfundimit të afatit të aplikimit në konkursin/procedurën RN00012066, për pozitën: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Ministria e Shëndetësisë, pasi ka bërë njoftimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këtë pozitë në kuadër të fazës së verifikimit paraprak të kandidatëve, ka vërejtur se në konkursin e shpallur, për shkak të unifikimit të formës së konkursit të brendshëm, kur është shpallur procedura e pranimit të jashtëm, nuk është përfshirë rregulla e njohjes dhe mënyrës së dëshmisë për përvojën e punës në sektorin privat.

Më saktësisht pika 7 e konkursit, përmbanë rregullat për njohjen dhe mënyrën e dëshmisë së përvojës së punës (i) në institucione publike (ii) në OJQ dhe (iii) përvojës së punës jashtë shtetit por nuk përmbanë rregullat për përvojën e punës së fituar në sektorin apo subjektin privat, të fituar territorit të Republikës së Kosovës ashtu sikurse përcaktohet/rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjisllacionin e aplikueshëm.

DMZP, duke vlerësuar se ky lëshim, mund të ketë shkaktuar pasoja në keqinformimin apo vënien në lajthitje të palëve, me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë, duke qenë se asnjëra palë që tashmë ka marrë

pjesë në procedurë nuk ka përfituar statusin e palës me përfitim të ligjshëm në proces, ka vendosur që të anulohet sipas detyrës zyrtare këtë procedurë dhe të njoftojë rishpalljen e menjëhershme me përfshirjen përmbajtësore të kritereve për përvojën e punës sikurse u sqarua më lartë.

DMZP pas konstatimit të çështjeve më lartë të sqaruara, duke vepruar në përputhje me nenin 53 (paragrafi 1) të Ligjit Nr.05/L – 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, citim ” *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj*”, me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë, sipas detyrës zyrtare, me këtë akt administrativ, anulon procedurën e konkurimit me numër të referencës RN00012066, për pozitën: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Ministria e Shëndetësisë.

Për sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në afatin prej 30 ditësh.



**Vendimi i dërgohet:**

- Ministrisë së Shëndetësisë
- AKPPM;
- Drejtorit të DMZP/MPB;
- Arkivit të MPB-së.